



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL	
Përmes: <i>PEC:</i>	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së. <i>B. Kym</i>	
Nga:	Venera Çerkini, U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL <i>Venera</i>	Datë: 05/03/2018
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë	020-223
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën Kirchhain - Gjermani, në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030

E miratuar më datë më datë: 28.02.2019

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.03.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi*** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Sokol Haliti, gradonačelnik Opštine Vitina Naim Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština-MALS	
Preko: ZA:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u. <i>B. Kumi</i>	
Od:	Venera Çerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS <i>[Signature]</i>	Datum, 05.03.2019
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Vitina	Br.020-223
Vrsta akta:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine, na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku.

Odluka za usvajanje inicijative gradonačelnika Opštine Vitina za podsticanje međunarodne saradnje sa opštinom Kirchhain - u Nemačkoj u okviru egende OUN-a za 2020-2030. godinu
Usvojena dana, 28.02.2019 godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 05.03.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u saglasnosti odredbama zakonodavstva na snazi, i kao takav može prioizvesti prvi efekat.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi osa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVO	
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA	
Forma: <i>04-3 10/19</i>	
Nr. Organi: <i>10/19</i>	Vlera: <i>10/19</i>
Org. B. Nr. <i>10/19</i>	Vlerësimi: <i>10/19</i>
<i>12-110/19-10/19</i>	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Vitina

Në pajtim me nenin 12 pika d, nenin 40 pika j të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores Nr. prot. 0203-1334, të datës 18.12.2012 për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, nenin 36 shkronja j, neni 36 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë, për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Kirchhain-Gjermani, në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030

Neni I

Kuvendit Komunal i Vitisë, miraton vendimin për AUTORIZIMIN e Kryetarit të Komunës së Vitisë, për të filluar konsultimet me Komunën e Kirchhain-Gjermani, të cilat janë në partneritetet të qëndrueshme në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030.

Neni II

Pas marrjes së autorizimit, Kryetari i Komunës së Vitisë e njofton Kryetarin e Komunës së Kirchhain-Gjermani, për nismën me të cilin kërkohet themelimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Verilimi u dorëzohet:

1. Kryetarit të Komunës;
2. MAPI-së;
3. Shërbimit të Kuvendit, dhe
4. Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS SË VITIN
KRYESES

Nani Dira